



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 5207, Datë 30.08.2017

**“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 6, gërma a) të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar,

KONSTATOJ :

Noterja Firdes Shuli i është drejtuar Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr. F - 131 prot, datë 23.08.2017, përmes së cilës kërkon të heq dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, për shkak të Vendimit të Kuvendit nr. 82/2017, datë 17.06.2017 “Për miratimin e listës së bllokut të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky vendim i Kuvendit është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 133, datë 19.06.2017. Me këtë vendim, është miratuar lista në bllok e kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe znj. Firdes Shuli është zgjedhur në pozicionin e Komisionerit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Në nenin 6, të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Heqja e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit bëhet me urdhër të Ministrit të Drejtësisë kur: a) *heq dorë me kërkesën e tij nga ushtrimi i profesionit të noterit;*

PËR KËTO ARSYE :

Në bazë të nenit 6, gërma a), të ligjit nr. 7829, datë 1.06.1994, “Për Noterinë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e lejes së ushtrimit të profesionit të noterit znj. Firdes Shuli, anëtare e Dhomës së Noterisë Gjirokastër, për shkak se heq dorë, me kërkesën e saj, nga ushtrimi i profesionit të noterit.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Z. Arlind Arapi, Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - b) Z. Erjon Ndreca, Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - c) Z. Ermal Jahaj, Inspektor në Drejtorinë e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira.
 - d) Një përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Noterisë.
 - e) Një përfaqësues i Dhomës së Noterisë Gjirokastër.
3. Arkivi do të merret në dorëzim me procesverbal në bashkëpunim me Dhomën e Noterisë, Gjirokastër. Arkivi do t'i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noterit të Dhomës së Noterisë Gjirokastër, z. Bujar Xhaxho.
4. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noteres Firdes Shuli, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
5. Ky urdhër së bashku me të dhënat përkatëse të regjistrohet në regjistrin e përgjithshëm të noterëve nga Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira
6. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit të Institucioneve të Varësisë dhe Profesioneve të Lira, pranë Ministrisë së Drejtësisë të marrë masat e nevojshme për njoftimin dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

GAZMENT BARDHI

Miratoi: Rledar Kabashi Drejtor Inspektimi IVPL
Punoi: Arlind Arapi Përgjegjës Sektori IVPL
Data: 30.08.2017/2 kopje

